V E N D I M
Nr.500, datë 18.7.2003

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË AVOKATIT TË POPULLIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në zyrën e Avokatit të Popullit të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes 1 – Diplomë e shkollës së lartë është 9 000 (nëntë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.

5. Shtesa për pozicion të jetë sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

6. Nivelet e pagave, sipas vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe të Kuvendit dhe disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", i ndryshuar, për emërtesat e mëposhtme të jenë:

- "shef kabineti i Avokatit të Popullit" barazohet në pagë me "këshilltarin e Kryeministrit";
- "këshilltari i Avokatit të Popullit" barazohet në pagë me "ndihmësin e Kryeministrit";
- "sekretari i Avokatit të Popullit" barazohet në pagë me "sekretarin e Presidentit, Kryetarit të Kuvendit,Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, nënkryetarit të Kuvendit";
- "sekretari në zyrën e Avokatit të Popullit" barazohet në pagë me "sekretar ministri".

7. Për punonjësit e tjerë të zyrës së Avokatit të Popullit të zbatohet lidhja II/4 "Nivelet e pagës sipas funksioneve në Këshillin e Ministrave", që i bashkëlidhet vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", i ndryshuar.

8. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

		Paga mujore			
Klasa	Emërtimi	Paga individuale (Paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
I-a	Sekretar i Përgjithshëm	9 000	2%	0	111 000
II-a	Ndihmëskomisioner kategoria e parë	9 000	2%	0	90 000

II-b	Ndihmëskomisioner kategoria e dytë Drejtor Drejtorie	9 000	2%	0	74 000
III-a	Përgjegjës sektori	9 000	2%	0	55 000
IV-b	Specialist	9 000	2%	0	20 000